<b>Prill</b>	<p>Fillimi i implementimit të projekteve.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e serave.</li> <li>2. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Bujqësi dhe Pylltari – haprja e rrugeve fushore.</li> <li>3. Trajtimi i qeneve emdacak.</li> <li>4. Hartimi i planit për mbjellje pranverore dhe monitorim.</li> <li>5. Vizita në teren.</li> <li>6. Organizimi i trajnimeve me organizata të ndryshme.</li> <li>7. Digjitalizimin e parcelave për subvencionim për fermeret që aplikojnë në programin për Pagesa Direkte në AZHB.</li> <li>8. Shqyrtimi i kërkesave nga komisioni, ku së pari bëhet dëmkosja e druve që bënë tekniku i APK-së, dhe jepet leje për prerje të druve nga njësia komunale pyjore në Suharekë.</li> <li>9. Vizita në teren të fermerëve në bazë të kërkesave të tyre drejtuar Dejtorisë së Bujqësisë.</li> </ol>

<b>Maj</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizim dhe monitorim i projekteve për kapitale të Drejtorisë së Bujqësisë</li> <li>2. Organizimi i procesit të vaksionimit për kafshë me Ambulancën Veterinare (AUVK).</li> <li>3. Vizita në teren.</li> <li>4. Realizimi i projektit: furnizimi me mekanizem bujqësor për fermerë</li> <li>5. Pastrimi dhe rrallimi i pyjeve publike në bashkëpunim me APK-në në njësinë menagjuese “Rakopeq” te vendi i quajtur Kroni i Mbretit dhe Stanet e Bukoshit.</li> </ol>
<b>Qershor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi i kërkesave të fermerëve të cilët aplikojnë në thirrjet publike të Drejtorisë.</li> <li>2. Vizitë në teren - monitorimi i projekteve.</li> <li>3. Përgatitja e Projektit në sektorin e Turizmit- Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit</li> <li>4. Parapërgatitje për fushatën e korrje-shirjeve – Ngritja e Shtabit për Korrje Shirje.</li> <li>5. Thirrja publike për fermeret që kanë plantacione të arrave.</li> </ol>
<b>Korrik</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Monitorimi i korrje - shirjeve.</li> <li>2. Monitorimi i projekteve në realizim.</li> <li>3. Realizimi i projektit - rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bagëti.</li> <li>4. Realizimi i projekteve - zhvillimi i turizmit rural - Ndërtimi i vendkampingjeve turistike dhe sinjalizimi i shtigjeve të ecjes.</li> </ol>
<b>Gusht</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Raporti përfundimtar për korrje - shirje</li> <li>2. Vizita fermerëve në teren</li> <li>3. Monitorim i projekteve gjatë realizimit.</li> </ol>
<b>Shtator</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizim të këshillave teoriko - praktike në teren.</li> <li>2. Përgatitja për ekspozitën e produkteve bujqësore “FESTARI 2024”</li> <li>3. Shqyrtimi i kërkesave të fermerëve dhe vizita në teren.</li> <li>4. Realizimi i projektit: Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore.</li> </ol>
<b>Tetor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizim dhe monitorimi i projekteve.</li> <li>2. Vizita në teren.</li> <li>3. Pyllzim me fidane të pishes në pyjet e zhveshura në sipërfaqe prej 40 ha.</li> <li>4. Regjistrimi i rregullt vjetor i dëmeve pyjore në të gjitha njësitë menagjuese nga Komisioni Komunal dhe APK-së, në pyjet publike që kontrollohen nga rojet e pyjeve në bashkëpunim me Agjencionin Pyjor të Kosovës.</li> </ol>
<b>Nëntor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Monitorimi i projekteve kapitale dhe përgatitja e raporteve në sistemin PIP-it për vitin aktual.</li> <li>2. Mbjellja e fidaneve me pishë në tokat pyjore.</li> <li>3. Vizita në teren për realizimin e projekteve zhvillimore.</li> <li>4. Përgatitja e CBA për projekte të mëdha dhe futja në sistemin PIP-it 3 vjeçar.</li> </ol>
<b>Dhjetor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Monitorimi i projekteve.</li> <li>2. Përgatitja e planit - buxhetor për bujqësi vitin 2024.</li> <li>3. Përgatitja e raporteve përfundimtare, gjatë vitit.</li> <li>4. Vizita në teren.</li> <li>5. Vlerësimi i punës së puntoreve.</li> </ol>

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

### Misioni

Arritja e strategjive, politikave dhe objektivave organizative – shëndetësore të

Komunës përmes menagjimit dhe organizimit efikas të DHSMS.

Organizon, koordinon dhe mbikqyrë organizimin e kujdesit parësor shëndetësor, shërbimi për nevoja sociale dhe strehim, mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik.

Nr	Detyrat	Afati i plotësimit	Përgjegjësit për implementim
1	Raportim Kryetarit të Komunës Kuvendit Komunal ministris së Shëndetësisë dhe Ministrisë për Mirëqenie Sociale si dhe pranim raporti nga QKMF, QPS, HENDIKOS si dhe Caritas	Javor, mujor dhe në mvarësi të kërkesave	Drejtori
2	Respektim i Ligjeve në lëminë e Shëndetësisë, rregulloreve dhe tëngjajshme	Rregullisht	DSHMS
3	Monitorimin dhe menagjimin e buxhetit të DSHMS, QKMF dhe QPS per projektet ne bazë të planit të prokurorimit per vitin 2024.	Gjatë tërë vitit	Drejtori i DSHMS Zyrtari për buxhet dhe financa
4	Kryerjen e pagesave të programeve buxhetore	Gjatë tërë vitit	Zyrtari për buxhet dhe financa
5	Planin e zotimeve dhe shpenzimeve	Janar	Zyrtari për buxhet dhe financa
6	Planifikimin e buxhetit për tri programet buxhetore	Korrik –Shtator	Zyrtari për buxhet dhe financa
7	Rishiqimin e buxhetit për tri programet buxhetore	Qershor	Drejtori i DSHMS Zyrtari për buxhet dhe financa
8	Kontrollimi dhe mbikqyrja e punëve dhe bashkëpagesave në QKMF, QMF, AMF dhe QPS.	Gjatë tërë vitit	Drejtori i DSHMS Udhëheqësi i DSHMS Zyrtari për buxhet dhe financa
9	Edukim të vazhdueshëm profesional të kuadrave shëndetësore, dhe trajnim të punëtorëve tjerë	Në vazhdimësi	Drejtori i QKMF-ës

10	Ngritja e cilësisë së shërbimëve shëndetësore. Pranimi i mjekëve në punë sipas nevojës në QKMF , QMF dhe ambulanca (sipas modulit me blerje të shërbimëve )	Nga fillimi e deri në fund të vitit	Drejtori i QKMF Drejtori i DSHMS Zyra e prokurimit Mundësia përmes OJQ-ve-me projekt
11	Ndërtimi i QMF- së në Gjinoc	Sipas planit të prokurorimit	DSHMS QKMF
12	Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë për realizimin e projektit Shendetit Nenes	Monitorim i vazhdueshëm i procesit	Ministria e Shëndetësisë DSHMS QKMF
13	Përcjellja e furnizimit me barëra nga lista esenciale dhe barëra të tjera	Gjatë tërë vitit 2024	DSHMS QKMF
14	Investimet kapitale: blerja dhe paisja me aparatura të nevojshme për QKMF “Rexhep Kuqi” – Suharekë.	Prej muajit Mars deri në Shtator	Drejtori i DSHMS Drejtoria e Shërbimeve Publike Drejtoria e Urbanizimit
15	Vitalizimi i infrastrukturës për funksionalizimin e projektit „Shtretërit shtëpiak “	Nga fillimi i vitit – projekt tre vjeçar	Kryetari i Komunës Drejtori i DSHMS, QKMF Karitas Kosova
16	Subvencionimi i Lindjeve në shumë prej 250 euro sipas vendimit të Asamblesë. Bonus banimi me vendim të Asamblesë Shërbimet e varrimit për qytetar - kultifetar	Gjatë tërë vitit sipas kërkesave Me shpallje publike Sipas kërkesave	DSHMS Menaxheri –ZKF – Kryetari
17	Përcjellja dhe mbikqyrja e cilësisë së ushqimit , ujit të pishëm , higjiena e ambientit (derdhja e ujërave të zeza, hedhja e mbeturinave dhe depunimi i tyre )	Së paku 3 herë gjat vitit	DSHMS
18	Dezinfektimi, Deratizimi dhe Dezinsektimi (DDD) i objekteve shoqërore.	Prill, Maj dhe Qershor 2024	DSHMS
19	Shërbime të pacientëve parashihen të realizohen sipas kërkesave	Gjatë tërë vitit	QKMF
20	Përkujdesi për Shëndetin oral	Gjatë tërë vitit	QKMF
21	Imunizim të fëmijëve dhe grup moshave tjera sipas nevojës	Gjatë tërë vitit	QKMF
22	Organizim të vizitave shëndetësore sistematike në Shkollë	Prill, Qershor dhe Tetor	Drejtori i DSHMS Drejtori i QKMF



23	Ristrukturim i kuadrove shëndetësore, për mbulimin e të gjitha punkteve shëndetësore me staf	Pas përfundimit të objekteve të reja Dhe në objektet e tashme d	Drejtori i DSHMS
24	Organizimi i vizitave sistematike të punëtorëve në organizata të ndryshme	Gjatë tërë vitit	QKMF
25	Shërim Banjo Klimatik	Sipas kërkesave	DSHMS
26	Ndihma skamnorëve me kategorin e Subvencioneve	Sipas kërkesave	DSHMS
27	Ndihma skamnorëve me pako ushqimore	Gjatë festave	Kryetari i Komunës DSHMS
28	Ndihmë dhe përkujdesje , ndaj familjeve të dëshmorëve dhe in validëve të luftës	Gjatë tërë vitit	DSHMS Zyrtari ligjor.
29	Përkujdesi për fëmijët e braktisur	Tërë vitin	QPS –DSHMS
30	Përkujdesi për familjet skamnore	Tërë vitin	QPS-DSHMS
31	Përciellja dhe rangimi në skemen sociale	Tërë vitin	QPS-DSHMS
32	Ndihme me mjete 4000 euro Shtëpia për mbrojtjen e Grave Prizren	Maj – Qershor	DSHMS
33	Bshkëpunimi me Ministrinë e PMS për skemnën sociale	Tërë vitin	QPS –DSHMS –MPMS
34	Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ,puna rreth zbulimit të trafikimit me qenje njerëzore	Tërë vitin	QPS –DSHMS –Policia e Kosovës
35	Bashkëpunim me SHPK, KFOR, OSCE ,FSK, Drejtorët e Drejtorive Komunale OQ, OJQ, shoqata të ndryshme dhe me Inspektorin Sanitar	Tërë vitin 2024	Drejtori

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PRONSORE-JURIDIKE DHE KADASTËR

"Drejtoria e Shërbimeve Pronsore-Juridike dhe Kadastër , gjatë këtij viti do të ofroj shërbime sa më efikase për qytetarët, duke u ofruar informacione dhe të dhëna për pronat e sektorit privat dhe atij komunal. Në zyrat pritëse të dy sektorëve, sektorin e kadastrit do të mbahen takime të rregullta me qytetarët. Gjatë takimeve palëve do tu ipen këshilla për plotësimin e lëndëve sipas kërkesave të palëve. Këto kërkesa kryesisht kanë të bëjnë me bartje të trashigimis, regjistrimin ose qregjistrime të hipotekave , qirambajtje në periudh afatshkurtë 1-15 vite, dhe periudhë afatgjate prej 15-99 vite, kërkesa për ndarje,

bashkim ose rregullim të kufijve në mes të palëve, shpronsime të pronave, këmbime (ndërrim) të pronave, uzurpime etj. Palëve ju ofrohet edhe ndihma për identifikim të pronave, sipërfaqes së pronës shfrytëzuesit aktual të pronës, si dhe historiate të parcelave të pronave private".

"Në këtë vitë Shërbimi Pronsor Juridik dhe Kadastri do të ofrojë bashkpunim të ngusht edhe me Drejtorit tjera".

"Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2024, ku DSHPJK planifikon të mbaj seanca të rregullta në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunes dhe të qytetareve të Suharekës, e të cilat janë të proceduara sipas akteve Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës". Përveç këtyre temave të cekura DSHPJK do të shqyrtoj dhe miraton edhe tema apo çështje tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunën e Suharekës. Edhe këtë vit në drejtorinë tonë do të shqyrtohen me prioritet lëndët për Ilegalizimin e objekteve.

Lista për dhenjë në shfrytëzim të pronave, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim në vitin 2023, do ta publikojmë në faqe të komunës, në menyrë që qytetarët të kenë më të lehtë qasjen ose identifikimin e pronave shoqërore për t'i marrur në shfrytëzim.

### **Planifikimi i planit të punës nga DSHPJK për vitin 2024.**

<b>"Janar - Dhjetor"</b>	
1.	Inicimi i procedurës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunes;
2.	Komplrtimin e mungeses se stafit esencial.
3.	Ndarja e parcelës
4.	Bashkimi i parcelave
5.	Procesiiri-rregullimit të kufirit,
6.	Ndërrimi i kulturës,
7.	Ndërrimi i përdorimit të tokës,
8.	Regjistrimi i ndërtesës,
9.	Ndarja e ndërtesës,
10.	Bashkimi i ndërtesave,
11.	Fshirja e ndërtesës nga regjistri,
12.	Regjistrimi I pjesës së ndërtesës
13.	Ndarja e pjesës së ndërtesës,
14.	Bashkimi i pjesëvetëndërtesës,
15.	Fshirja e pjesës së ndërtesës nga regjistri,
16.	Ndryshimi I mënyrës së përdorimit të ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës,
17.	Ndryshimi I llojit të të drejtave dhe formave të pronësisë së pronave të paluajtshme,
18.	Regjistrimi i të drejtës së pronësisë,
19.	Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit,
20.	Regjistrimi i të drejtësëqirasë,

21. Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e servitutit,
22. Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e hipotekës,
23. Korrigjimin e gabimeve materiale,
24. Korrigjimi/plotësimi I të dhënave për pronar/shfrytëzues dhe
25. Korrigjimi i të drejtave mbi pronat e paluajtshme.
26. Identifikimi i pronave të paluajtshme dhe
27. Korrigjimi i gabimeve teknike.
28. Shqyrtimi e kërkesave të palëve që kanë të bëjnë me bartje të trashigimis, regjistrimin ose qregjistrime të hipotekave , qirambajtje në periudh afatshkurtë 1-15 vite, dhe periudh afatgjate prej 15-99vite , kërkesa për ndarje, bashkim ose rregullim të kufijve në mes të palëve, shpronsime të pronave, këmbime (ndrrim) të pronave, uzurpime etj.
29. Inicimi i procedurave për shpronësimin e pronave për interes publik, bazuar në Planin Zhvillimore Komunale, për realizimin e projekteve me interes të përgjithshëm.
30. Zhvillimi i procedurave nga Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
31. Miratimi i raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronës së paluajtshme të Komunës;
32. Raport nga Drejtoria e pronës për qiranë dhe rentën;
33. Zhvillimin e procedurave për këmbimin e pronës.
34. Realizimi i të hyrave në ZKK Suharek nga taksat e qytetarëve. Planifikohen rreth 120.000€ - 140.000€.
35. DSHPJK edhe këtë vitë do të shqyrtoj me prioritet kërkesat për LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE - DHE REGJISTRIMIN NË ZYRËN KOMUNALE KADASTRALE".

## DREJTORIA PER URBANIZEM PLANIFIKIM DHE MJEDIS

### PLANI I PUNES

#### JANAR – DHJETOR 2024

M	Detyrat e punës të klasifikuara nëpër muaj	Përgjegjës
JANAR	-Kërkesa për zyrtaret për efikasitetin në punë, për shërbime më të mira ndaj qytetarët, respektim të orarit të punës dhe për punë më profesionale.	Drejtori
	-Shqyrtimi dhe mbyllja e lëndëve të vitit 2023	Të gjithë zyrtaret e DUPM-së
	-Inicimi i procedurave për hartimin e Rregullores së Banuesve të ndërtimit.	Drejtori me Sektorin e planifikimit
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi monitorues

	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi monitorues
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit	G.Pun. për Legalizim
	-Vlerësimi i stafit të drejtorisë për punën e bërë gjatë viti 2023.	Drejtori
	-Përmbyllja e raporteve vjetore nga zyrtaret me një përshkrim detal rreth zhvillimeve në drejtori për vitin 2023.	Të gjithë zyrtaret e DUPM-së
	-Trajtimi i lendeve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Punimi i raportit vjetor për vitin 2023.	Drejtori dhe Shefi i DUPM
	-Punimi i programit të punës për vitin 2024	Drejtori dhe Shefi i DUPM
<b>SHKURT</b>	-Diskutim dhe dhënia e ideve rreth transparencës në Drejtori ndaj qytetareve dhe efikasitetit tonë në punë.	Të gjithë zyrtaret e DUPM
	-Formimi i komisionit punues në rregulloren e banueseve	Kryetari
<b>MARS</b>	-Trajtimi i lendeve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit	G.Pun. për Legalizim
	-Hartimi i detyrës projektuese për Planin Rregullues të Hollësishëm - Zona Industriale në Shirokë	Spektori i planifikimit
	-Hartimi i detyrës projektuese për Planin Rregullues të Hollësishëm - Zona Industriale në Duhel	Spektori i planifikimit
	-Hartimi i programit të punës të komisionit për rregulloren rreth bonuseve	Komisioni
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit	G.Pun. për Legalizim
	-Punimi i projekpropozimeve si dhe i paramasave dhe paralogarive për iniciimet e procedurave të projekteve investitive në përgjegjësi të komunës.	Drejtori dhe stafi i drejtorisë
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Trajtimi i lendeve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Inicimi i procedurës për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm - Zona Industriale në Shirokë	Spektori i planifikimit
	-Inicimi i procedurës për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm - Zona Industriale në Duhel	Spektori i planifikimit

<b>PRILL</b>	-Hartimi i drafte rregullore se bonuseve.	Komisioni
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit	G.Pun. për Legalizim
	-Inicimi i procedurave për hartimin e rregullores mbi dhënën në shfrytëzim të pronës publike në kuadër të sheshit gjatë sezonit veror dhe dimeror.	Kryetari
	-Formimi i grupës punësë për hartimin e programit të menaxhimit të sheshit.	Kryetari
	-Trajtimi i lëndëve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Vendosja në diskutim publik të rregullores së bonuseve	Drejtori
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit.	G.Pun. për Legalizim
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Fillimi i procesit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm - Zonës industriale në Shirokë	Spektori i planifikimit
	-Fillimi i procesit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm Zonës industriale në Duhel	Spektori i planifikimit
<b>QERSHOR</b>	-Raport tremujor	Zyrtaret
	-Diskutim dhe dhënia e ideve rreth transparencës në Drejtori ndaj qytetareve dhe efikasitetit tonë në punë.	Të gjithë zyrtaret e DUPM-së
	-Trajtimi i lëndëve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Rishikimi i vërejtjeve dhe komenteve të qytetarëve rreth rregullores së bonuseve	Drejtori, komisioni dhe sektori i planifikimit
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit.	G.Pun. për Legalizim
	-Rishqyrtimi i të arriturave gjashtëmujore, përparimet, ngecjet, sfidat dhe diskutimi i mundësive për një zhvillim sa më të qëndrueshëm të drejtorisë.	Të gjithë zyrtaret e DUPM-së
	-Menaxhimi i projekteve nën përgjegjësin e drejtorisë si dhe mbikëqyrja e tyre.	Menaxheri i projekteve
	-Takim informues me Qytetar për Planin Rregullues të Hollësishëm - ZI Shirokë	Drejtori, Shefi dhe Spektori i planifikimit
	-Takim informues me Qytetar për Planin Rregullues të Hollësishëm - ZI Duhel	Drejtori, Shefi dhe Spektori i planifikimit

	<b>Të përgjithshme-aktivitete të përsëritura në përditshmërinë e gjashtëmujorit të parë</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Shqyrtimi i lëndëve të pranuar dhe kthimi i përgjigjeve në kohë të caktuar.</li> <li>-Zotimet e mjeteve dhe iniciimet e Procedurave për Prokurim rreth projekteve kapitale.</li> <li>-Hartimi i raporteve javore, mujore, tremujore, gjashte mujore dhe vjetore sipas mundësisë dhe nevojës.</li> <li>-Konsultime të vazhdueshëm me drejtorit komunale varësisht nga nevojat e drejtorisë.</li> <li>- Pritja e palëve, informimi i tyre rreth kërkesave të parashtruara dhe evidentimi i mangësive eventuale në dokumentet planifikuese.</li> <li>-Raportimet dhe barazimet financiare.</li> <li>-Etj.</li> </ul>	<p>Të gjithë zyrtaret përgjegjës</p> <p>Zyrtari përgjegjës Drejtori, shefi dhe zyrtaret Drejtori shefi dhe zyrtaret Të gjithë zyrtaret e drejtorisë Juristi i drejtorisë</p>

	-Kërkese nga zyrtaret për efikasitetin në punë, për shërbime më të mira për qytetaret, respektim të orarit të punës dhe për punë më profesionale.	Drejtori dhe Shefi
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit.	G.Pun. për Legalizim
	-Raportim rreth procesit të Legalizimit	Juristi i drejtorisë
	-Përmbyllja e raporteve gjashtëmujore nga zyrtaret me një përshkrim detal rreth zhvillimeve në drejtori.	Të gjithë zyrtaret e drejtorisë
	-Aprovimi i rregullores së bonuseve	Asambleja Komunale

<b>GUSHT</b>	-Hartimi i raportit gjashtëmujor të drejtorisë.	Drejtori dhe Shefi
	-Hartimi i Drft-rregullores mbi dhënën në shfrytëzim të pronës publike në kuadër të sheshit gjatë sezonit veror dhe dimëror.	Komisioni
	-Trajtimi i lendeve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Hartimin e programit të menaxhiit të sheshit.	Ekipa punuese
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimi	G.Pun. për Legalizim
	-Inicim i procedurave për Asamble për vendosje në shqyrtim publik të Planin Rregullues të Hollësishëm - ZI Shirokë	Sektori i planifikimit
	Inicim i procedurave për Asamble për vendosje në shqyrtim publik të Planin Rregullues të Hollësishëm - ZI Duhel	Sektori i planifikimit

	-Trajtimi i lendeve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Mbajtja e takimeve me ekipin e monitorimit të HZK-së dhe PZHK-së	Drejtori dhe sektori i planifikimit
	-Vendosja në diskutim publik e drft rregullores mbi dhënën në shfrytëzim të pronës publike në kuadër të sheshit gjatë sezonit veror dhe dimëror.	Drejtori dhe sektori i planifikimit
<b>SHTATOR</b>	- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit.	G.Pun. për Legalizim
	- Hapja e shqyrtimit publik për Planin Rregullues të Hollësishëm - ZI Shirokë	Drejtori dhe sektori i planifikimit
	- Hapja e shqyrtimit publik për Planin Rregullues të Hollësishëm - ZI Duhel	Drejtori dhe sektori i planifikimit
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Trajtimi i lëndëve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
<b>TETOR</b>	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit	G.Pun. për Legalizim
	-Raport nëntëmujor	Të gjithë zyrtaret e drejtorise
	-Aprovimi i rregullores mbi dhënën në shfrytëzim të pronës publike në kuadër të sheshit gjatë sezonit veror dhe dimëror.	Asambleja Komunale
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
<b>NENTOR</b>	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Trajtimi i lëndëve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës
	-Hartimi i raportit të shqyrtimit publik për Planin Rregullues të Hollësishëm - ZI Shirokë	Sektori i planifikimit
	-Hartimi i raportit të shqyrtimit publik për Planin Rregullues të Hollësishëm - ZI Duhel	Sektori i planifikimit
	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit.	G.Pun. për Legalizim
	-Shqyrtimi i kërkesave dhe lëshimi i certifikatave për përdorim për projektet komunale të menaxhuara nga drejtorit tjera si dhe nga Drejtoria e urbanizmit sipas procedurave ligjore.	Zyrtari përgjegjës me komisione përkatëse sipas nevojës

	-Mbajtja e takimeve me ekipin e monitorimit të HZK-së dhe PZHK-së	Drejtori dhe sektori i planifikimit
	-Përmbyllja e projekteve kapitale të cilat janë nën menaxhimin e drejtorisë.	Të gjithë menaxheret e projekteve
	-Trajtimi i lendeve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Diskutim publik rreth monitorimit të PZHK	Drejtori dhe sektori i monitorimit
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Diskutim publik rreth monitorimit të HZK	Drejtori dhe sektori i monitorimit
	-Inicimi i procedurave për aprovim në Asamblenë komunale për aprovim të Planit Rregullues të Hollësishëm - ZI Shirokë	Drejtori, Shefi dhe sektori i planifikimit
	-Inicimi i procedurave për aprovim në Asamblenë komunale për aprovim të për Planit Rregullues të Hollësishëm - ZI Duhel	Drejtori, Shefi dhe sektori i planifikimit
<b>DHJETOR</b>	-Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit	G.Pun. për Legalizim
	-Përmbyllja e projekteve kapitale të cilat janë nën menaxhimin e drejtorisë.	Të gjithë menaxheret e projekteve
	-Shqyrtimi i kërkesave dhe lëshimi i certifikatave për përdorim për projektet komunale të menaxhuara nga drejtorit tjera si dhe nga drejtoria e urbanizmit sipas procedurave ligjore.	Zyrtari përgjegjës me komisione përkatëse sipas nevojës
	-Përmbyllja e aktiviteteve nga komisionet e ndryshëm të formuara nga drejtoria apo kryetari e që kanë të bëjnë me punën në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit.	Juristi i drejtorisë
	-Trajtimi i lendeve të kategorisë I dhe II rreth Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit	Zyrtaret përgjegjës të DUPM-së
	-Monitorimi i PZHK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Monitorimi i HZK-së	Drejtori dhe Ekipi për monitorim
	-Përgatitja e Raporteve finale për të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë këtij viti në drejtori si dhe për punën individuale të çdo zyrtari.	Të gjithë zyrtaret e drejtorisë
	-Përgatitja e draft raportit vjetor të drejtorisë	Drejtori me shefin e DUPM
	- Raporti në Asamblenë Komunale për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së.	Drejtori me Ekipin monitorues
	- Raporti në Asamblenë Komunale për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së.	Drejtori me Ekipin monitorues
	- Raporti në MMPHI për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së.	Drejtori
	- Raporti në MMPHI për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së.	Drejtori



-Hartimi i raportit rreth Legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje.	Juristi i drejtorisë
<b>Të përgjithshme-aktivitete të përsëritura në përditshmërinë e gjashtëmujorit të parë</b>	
-Shqyrtimi i lëndëve të pranuar dhe kthimi i përgjigjeve në kohës të caktuar. -Zotimet e mjeteve dhe inicimet e Procedurave për Prokurim -Hartimi i raporteve javore, mujore tremujore, gjashte mujore dhe vjetore sipas mundësisë. -Konsultime të vazhdueshëm me drejtorit komunale varësisht nga nevojat e drejtorisë. - Pritja e palëve, informimi i tyre rreth kërkesave të parashtruara dhe evidentimi i mangësive eventuale në dokumentet planifikuese. -Raportimet dhe barazimet financiare. -Etj.	Të gjithë  Zyrtari përgjegjës Drejtori dhe Juristi i drejtorisë Drejtori dhe Shefi i DUPM Të gjithë  Juristi i drejtorit Juristi i drejtorisë se

Në planin e punës së përshkruar më lartë janë paraqitur vetëm aktivitetet kryesore që zhvillohen në drejtori.

**Prioritet për vitin 2024 do të jetë:**

- Përmbyllja e procesit rreth lëndëve të legalizimit
- Zbatimi i PZHK-së 2021-2029 dhe hartimi i raportit monitorues.
- Zbatimi i HZK-së dhe hartimi i raportit monitorues.
- Hartimi i programit për menaxhim të sheshit.
- Aprovimi i rregullores për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të sheshit.
- Hartimi i rregullores së bonuseve

## DREJTORIA PËR EKONOMI, BUXHET DHE FINANCA

<b>Plani Vjetor i Punës në Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa</b>							
Drejtori: Labinot Halitjaha		Komuna: Suharekë			Viti: 2024		
<b>QËLLIMI:</b> Përgaditja e faturave, shpërndarja, realizimi i te hyrave, hartimi i KAB-it për vitet 2024/2026, hartimi i buxhetit të vitit 2024, realizimi i te hyrave vetanake si dhe realizimi dhe shpenzimit i buxhetit.							
Aktiviteti	Departamenti i cili është i angazhuar <input type="checkbox"/>	Data e fillimit	Data e zbatimit	Burimet e nevojshme (stafi, pajisjet teknike etj.)	Buxheti i nevojshëm	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Vërejtje

1.1 Marrja e faturave me CD nga Ministria e financave respektivisht Departamenti i Tatimit ne Pronë	Sektori i Tatimit ne Pronë-Suharekë	Jana r 2024	Mars 2024	Automjeti per personin zyrtar	30.00 €	Furnizimi me Cd te faturave te TPR-se	
1.2 Printimi i faturave dhe kategorizimi i faturave sipas vendbanimeve	Sektori i Tatimit ne Pronë-Suharekë	Jana r 2024	Mars 2024	Leter e nevojshme dhe printer	200.00 €	Perfundimi i faturimit me kohe	
1.3 Pergaditje per shperndarje te faturave ( Marrveshje me Posten e Kosoves).	Sektori i Tatimit ne Pronë-Suharekë + Posta e Kosovës	Jana r 2024	Mars 2024	Posta e Kosovës	10,000.00	Shperndarja e faturave me kohe ne te gjitha vendbanimet	
1.4 Ngarkesa e Takses ne Aktivitet,Rentes dhe Qirase	Sektori i Financave	Jana r 2024	Mars 2024	Stafi i Sektorit te Financave	500.00	Realizimi i ngarkesave deri ne fund te muajit Mars -2023	
<b>Aktiviteti</b>	<b>Departamenti i cili <input type="checkbox"/> është i angazhuar</b>	<b>Data e fillimit</b>	<b>Data e zbatimit</b>	<b>Burimet e nevojshme (stafi, pajisjet teknike etj.)</b>	<b>Buxheti i nevojshëm</b>	<b>Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm</b>	<b>Vërejtje</b>
1.5 Shperndarja e faturave te Takses ne Aktivitet,Rentes dhe Qirase	Sektori i Financave + Posta e Kosovës	Janar-2024	Mars-2024	Posta e Kosovës	2,500.00 €	Shperndarja me kohe e faturave për te gjithë obliguesit	
1.6 Realizimi i te hyrave nga Tatimi ne pronë dhe shperndarja e vërejtjeve per Tatimpaguesit te mëdhenj	Sektori i Tatimit në Pronë	I vazhdu eshem		Zyrtarët kompetent të cilët ekanë në përshkrim te detyrave te punes	500.00	Realizimi sa më i madhë i të hyrave vetanake e sidomos arritja e realizimit sipas planifikimit	

1.7 Sensibilizimi i qytetareve me afatet e pagesave te TPR-se dhe taksave te tjera	Drejtoria se bashku me media lokale +IT komunës	I vazhdu eshëm		Mediat lokale dhe IT Komunës	1000.00 €	Informimi me kohë dhe sensibilizimi i qytetareve per pagesa te borgjeve te tyre	
1.7.1 Inkasimi i të hyrave vetanake nga TPR,Taksa ne biznes,Renta dhe Qira permes procedurave permbarimore	Sektori i Tatimit ne Prone dhe Sektori i Financave	I vazhdu eshëm		Zyrtarët përgjegjës në bashkëpunim me Shefat e Sektorëve dhe Media	10,000.00 €	Ndjekja e te gjitha procedurave ligjore per inkasim te detyrueshëm si dhe arritje e inkasimit te te hyrave vetanake te cilat jane akumuluar si borgje te vjetra.	
1.8 Realizimi i te hyrave vetanake nga Taksa ne Aktivitet,Renta dhe Qiraja	Sektori i Financave	I vazhdu eshem		Zyrtarët kompetent që i kanë në përshkrim te detyrave te punes	1000.00 €	Realizimi sa më i madhë i të hyrave vetanake e sidomos arritja e realizimit sipas planifikimit	
1.9 Hartimi i Kornizes afatmesme Buxhetore	Drejtoria e Financave dhe Drejtorit tjera si dhe grupet tjera te interesit	Maj-2024	Qershor-2024	Informatat per te gjitha investimet kapitale dhe shpenzimet tjera buxhetore.	300.00 €	Perpilimi sa më efikas dhe ne perputhje me PZHK dhe kerkesat e qytetareve dhe grupet tjera te interesit .	
1.10 Dorëzimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore ne Komitetin për Politik dhe Financa dhe ne Asamble Komunale	Drejtoria e Financave	Qershor-2024		Dokumenti i pergaditur ne kopje fizike dhe elektronike	Ska buxhet	Aprovimi i Kornizes Afatmesme buxhetore	

1.11 Hartimi i buxhetit per vitin 2024	Drejtoria e financave dhe Drejtorit tjera	Gusht 2024	Shtator 2024	Informatat per te gjitha investimet kapitale dhe shpenzimet tjera buxhetore.	Ska buxhet	Perpilimi sa më efikas dhe ne perputhje me PZHK dhe kerkesat e qytetareve dhe grupet tjera te interesit .	
<b>Aktiviteti</b>	<b>Departamenti i cili <input type="checkbox"/> është i angazhuar</b>	<b>Data e fillimit</b>	<b>Data e përfundimit</b>	<b>Burimet e nevojshme (stafi, pajisjet teknike etj.)</b>	<b>Buxheti i nevojshëm</b>	<b>Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm</b>	<b>Vërejtje</b>
1.12 Dorëzimi i Buxhetit per vitin 2024 ne Komitetin për Politik dhe Financa dhe ne Asamble Komunale	Kryetari i Komunes dhe DEFB	Shtator 2024		Dokumenti i pergaditur ne kopje fizike dhe elektronike	Ska buxhet	Aprovimi i buxhetit per vitin vijues 2024	
1.13 Arritja e verifikimit dhe regjistrimit te objekteve dhe tokes se paluejtshme sipas Ligjit te Tatimit ne Prone	Sektori i Tatimit në Pronë	I vazhdueshëm		Ekipi i terenit dhe automjeti	1000.00 €	Arritja e verifikimit te pronave ne Komunën tonë ( së paku 20% te faturave ekzistuese ).	
1.14 Ofrimi i shërbimeve sa më efikase dhe përmes sistemit online	Drejtoria e Financave	Në vazhdi mësi		Stafi qe kujdeset për shërbim të qytetarëve dhe IT	Ska buxhet	Shërbim sa më të shpejt dhe efikas.	
1.14 Realizimi i buxhetit dhe shpenzimi i buxhetit	Drejtoria e Financave në bashkëpunim me Drejtorit tjera	Në vazhdi mësi		Të gjithë Drejtorët dhe zyrtarët tjerë të cilët janë të angazhuar në këtë proces.	Ska buxhet	Realizimi dhe shpenzimi i buxhetit në tërësi.	

1.15 Renovimi i disa zyreve ne DEFB	Drejtoria e Financave	2024	2024	Kompania e kontraktuar	3,000.00 €	Kushte me te favorshme te punes
1.16 Furnizimi me IPAD per sektorin e TPR-se	Drejtoria e Financave	2024	2024	Kompania e kontraktuar	3,000.00 €	Rexhistri m me te shpejt dhe efikas te pronave

## DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

### Sektori I gjendjes civile

Qëllimi kryesor	Aktiviteti	Kryerësi i punëve	Koha e realizimit
1. Plotësimi, përditësimi dhe administrimi i Regjistrave të Gjendjes Civile, Mbajtja e akteve të gjendjes civile, Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile si dhe ofrimi i shërbimeve më efikase dhe më të shpejta për qytetarët. Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve dhe aftësimi profesional i zyrtarëve të gjendjes civile. Aplikimi i	1. Furnizimi me regjistra të gjendjes civile dhe certifikata. Furnizimi me kompjuter dhe pajisje, përcjellëse (printer, fotokopjues, skaner, etj.) dhe furnizimi me material shpenzues për nevojat e gjendjes civile.	Udhëheqësi i sektorit të gjendjes civile në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë për administratë.	Janar-Mars Prill-Qershor Korrik-Shtator Tetor-Dhjetor
	2. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	3. Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile (Lindje, Martesa, vdekje etj)	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	4. Përditësimi dhe administrimi i të dhënave të gjendjes civile në regjistrat fizik dhe në regjistrin elektronik	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	5. Kurorëzimet dhe organizimi i ceremonisë së kurorëzimeve dhe pajisja me certifikatë dhe broshurë familjare	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	6. Regjistrimi i shtetasve në regjistrin fizik dhe elektronik dhe pajisja me certifikatë të shtetësisë si dhe aplikimi për natyralizim i shtetasve të huaj dhe aplikimi për humbje të shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim.	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore

sistemit Online për qytetarët.	7. Përmirësimet dhe korrigoimet e shënimeve personale në regjistrat e gjendjes civile, ndërrimi i emrit personal dhe përcjellja e shënimeve të më vonshme dhe anë shënimeve në regjistrat e gjendjes civile.	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
--------------------------------	--	---------------------------	-----------------------

#### Sektori:-Qendra për shërbime të qytetarve-ONE-STOP-SHOP

Qëllimi kryesor	Aktiviteti	Personeli përgjegjës	Afati
Lehtësues I procedurave administrative të përgjithshme komunale Përmisues I kualitetit të shërbimeve për qytetarë Efikasitet kohor të shqyrtimit të kërkesave	Komunikimi korrekt me qytetar	Udhëheqësi I Qendrës dhe personeli ndihmës	Sipas kërkesës së palëve
	Përgatitja dhe vënja në dispozicion e broshurave informative për qytetar dhe publikimi në WEB faqe	Udhëheqësi I Qendrës në bashkpunim me zyrtarin për informim	Sipas detyrës zyrtare
	Këshillimi dhe ndihma juridike për mënyrën e plotësimit të kërkesave dhe parashtresave	Zyrtarët e drejtorive përkatëse	Sipas kërkesës së palëve
	Shërbime të shpejta dhe efikase për qytetarë ne te njejtin vend kërkon zgjidhje dhe pranon edhe përgjigjen rreth kerkeses se tij. Pranimi dhe regjistrimi I kërkesave	Zyrtarët për pranimin e ankesave dhe kerkesave	Sipas kërkesës së palëve
	Shërbimi dhe asistimi I qytetarëve në një kënd me shërbime online nga sitetemi I E-Kosova	Asistenti	Sipas detyrës zyrtare

#### Sektori për punë të përbashkta dhe teknologji informative

Qëllimi kryesor	Aktiviteti	Personeli përgjegjës	Afati
	Kujdesi për zbatimin e e	IT e Komunes	Sipas kontrates

Avansimi në përdorimin E-Qeverisjes.	politikës së sigurisë së rrjetit		
	Mirmbajtja dhe ofrimi I mbështetjes për rrjetën internë të Komunës	IT e Komunes	Sipas kontratës
	Ofrimi I ndihmës së personelit të administrates komunale në përdorimin e TI.	Zyrtari për teknologji informative	Sipas kërkesës së personelit
	Mirmbajtja e TI	Zyrtari për teknologji informative	Sipas nevojës
	Furnizimi me paisje të TI. Për nevoja të administrates së Komunës	Zyrtari për teknologji informative në bashkpunim me drejtorin e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme	Sipas nevojës
Zbatimi i Akteve ligjore për gjuhët zyrtare në Komunë	Përkthimi i dokumenteve zyrtare të Komunës	Zyrtari për përkthim	Sipas detyrës
Sigurimi I objektit të Komunës	Përkujdesja 24 orë për ruajtjen e objektit të Komunës dhe autoparkingut	Kompania “Meb Security”	Në bazë të Kontratës
Mirmbajtja e objektit të Komunës	Mirmbajtja e higjienës në objektin e Komunës gjatë ditëve të punës	Kompania “BENI”	Në bazë të Kontratës

## DREJTORIA PËR INSPEKSION

**1.Drejtoria për Inspeksion** do të jetë përgjegjëse për këto detyra:

1. Që të zbatojë ligjet dhe aktet tjera nënligjore si dhe Rregulloret e Kuvendit Komunal të Suharekës;
2. Inspektorët, sipas përgjegjësisë dhe kompetencave, kanë për qëllim përcjelljen, monitorimin dhe marrjen e masave, përmes vendimeve dhe konkluzioneve administrative, në funksion të mbikëqyrjes inspektuese, të fushave të rregulluara me ligje, akte nënligjore, vendime dhe urdhëresa në fuqi;
3. Ushtron kontrollimin dhe inspektimin e objekteve industriale, tregtare dhe depove të mallrave-produkteve për treg;

4. Bën përcjelljen e çmimeve të artikujve dhe shikimin e faturave të tregtisë me shumicë dhe pakicë;
5. Hulumtojnë, konstatojnë, evidentojnë, udhëzojnë, evitojnë, ekzekutojnë dhe ushtrojnë fletëparaqitje në gjykatë;
6. Inspektorati kujdeset që të zbatohet plani urbanistik, gjegjësisht inspektimin e lejeve ndërtimore që lëshohen sipas dispozitave ligjore në fuqi;
7. Mbrojtja e konsumatorëve, gjegjësisht kujdesi për produktet ushqimore dhe jo ushqimore, të jenë në nivelin e duhur;
8. Mbrojtja e punëtorit në punë, mbrojtja dhe marrja e masave nga sëmundjet në: shëndetësi, bujqësi, ambient, komunikacion, shërbime publike, etj;
9. Koordinon aktivitetin dhe jep pëlqimin për veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, me kompanitë publike dhe shoqatat e taksistëve individual dhe operatorëve juridik sipas rregulloreve;
10. Bën mbikëqyrjen e mbrojtjes së ambientit në aspektin e mbeturinave, kanalizimit, ujit, shërbimeve tjera publike, për parandalimin e ndotjes dhe dëmtimin e ambientit.
11. Bën mbikëqyrjen e aktiviteteve të cilat shkaktojnë çrregullime të përgjithshme në ambient, materiet e rrezikshme dhe zonat e mbrojtura në natyrë duke identifikuar palën përgjegjëse.
12. Cakton linjat dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve; 18.2.12 bashkëpunon me policinë për rregullimin e komunikacionit dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion, në veçanti afër shkollave dhe institucioneve parashkollore;
13. Bën mbylljen e rrugëve për shfrytëzimin e tyre në raste të veçanta (festa shtetërore, punë të veçanta në interes të shtetit dhe komunës dhe punë të ngjashme);
14. Kontrolli i hapësirave afariste, objekteve, pajisjet, prodhimin, qarkullimin dhe transportin e mallrave me origjinë bimore;
15. Merr masa për ruajtjen e shëndetit publikë dhe urdhëron tërheqjen e mallit të dyshimtë nga qarkullimi si dhe asgjësimin e tij;
16. Ushtron edhe kompetenca tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror.

## **2. QELLIMET E INSPEKTIMIT**

Inspektimet kanë për qëllim:

- Zbatimit të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore;
- Mbrojtja e interesit të përgjithshëm publik;
- Mbrojtja e interesave të ligjshme të subjekteve të inspektimit;
- Qëllimet e inspektimit arrihen nëpërmjet:
- Respektimi i parimeve ligjore;
- Respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i Inspektimit;
- Këshillimi i subjektit të inspektimit për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore;
- Urdhërimi për korrigjim të shkeljeve ligjore dhe eliminimin e pasojave që dalin prej tyre;
- Shqiptimi i dënimeve, marrja e masave tjera administrative, inicimi i Procedurës Kundervajtëse dhe inicimi i Kallëzime Penale.

## **3. AKTIVITETET E INSPEKTIMIT**

Aktivitete inspektuese për realizimin e objektivave në inspektim janë:

- Inspektimi i veprimtarive-subjekteve afariste të cilat janë subjekt i inspektimit;
- Përgjigjja në kërkesa zyrtare;
- Trajtimi i rasteve ad-hoc;



- Perpilimi i procesverbaleve, nxjerrja e vendimeve dhe akteve tjera dhe ekzekutimit i tyre;
- Paraqitja e shkeljeve Kundërvajtëse dhe Kallëzimeve Penale.

#### **4. PRIORITETET E INSPEKTIMIT**

- Inspektimet do të klasifikohen sipas rëndësisë: të përgjithshme dhe të veçanta.
- Inspektime të rëndësisë së përgjithshme, janë inspektime që bëhen në subjekte të cilat inspektohen në intervale dhe kohë të caktuara, karakteri dhe rëndësia e të cilave mund të jenë të ndryshme, por funksionimi i tyre është i rregullt dhe si të tilla janë të parashikuara. Organizimi i inspektimit në këto subjekte do të bëhet sipas rëndësisë, kohës dhe karakterit të tyre.
- Inspektime të rëndësisë së veçantë, janë inspektime të pa parashikuara, të cilat për nga rëndësia dhe karakteri kërkojnë intervenim të veçantë. Këto inspektime nuk parashikohen të realizohen në agjendë të rregullt, mirëpo trajtimin i tyre do të bëhet me prioritet. Inspektime të rëndësisë së veçantë është rasti kur kemi të bëjmë me rrezikim të jetës dhe shëndetit e njerëzve.

##### **4.1 Kapaciteti dhe Struktura e Drejtorise se Inspektionit**

Drejtoria e Inspektionit ndahet në këto sektorë:

- Sektori Komunal Mjedisor
- Sektori i Tregut
- Sektori i Ndërtimit
- Sektori i Komunikacionit

#### **5. INSPEKTORI KOMUNAL – MJEDISOR**

Në vitin 2024, Inspektori Komunal-Mjedisor, në bazë të dispozitave të: Ligji mbi Inspektoriatin 04/L-175, rregullores komunale nr.nr. 01 nr. 109 për mirëmbajtjen e pastërtisë në teritorin e komunës së Suharekës dhe Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Suharekës, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 06/2018 për Ndëshkime me Gjoba Mandatore, Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbyes Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit për 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit mbi Kundërvajtjet, si dhe ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve tjera të cilat përcaktojnë punën, kompetencat dhe fushëveprimin e inspektorëve, si dhe në bazë të këtij plan-programi, do të kryejnë këto punë:

Mbyllja, përgatitja dhe arkivimi i lëndëve, në afatin e paraparë ligjor për vitin 2024;

- Prioritet do të jetë mbikëqyrja e vazhdueshme e hedhjes së mbeturinave, kryesisht nga personat privat dhe eliminimi i deponive ilegale në të gjithë territorin e komunës.
- Ndërmarrja e masave të parapara me dispozitat e Rregullores përkatëse, për pastrimin e borës dhe akullit nga sipërfaqet dhe objektet publike nga ana e qytetarëve, pronarëve të subjekteve afariste, organeve, institucioneve, ndërmarrjeve publike etj;
- Nga marsi deri në shtator 2024, do të bëj inspektime ndaj subjekteve afariste –hoteliere të cilat bëjnë vendosjen e tavolinave, karrigeve, kiosqeve, gjeneratorëve si dhe ekspozim të mallrave para objekteve afariste, pa lejen e organit kompetent;
